



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 12 PRILL 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
12. APRILA 2012. GODINE**

**Prill – April
2012**

E enjte, 12 prill. 2012, ora 10:32

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë e deputete,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare. Faleminderit!

Glauk dhe Visar, besoj që e kryet protestën tuaj. Unë kisha thënë që t'i zini vendet tuaja.

(Ndërprerje e incizimit)

Kryetarët e grupeve parlamentare dhe anëtarët e Kryesisë kanë një takim të shkurtër.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Unë po kërkoj nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, që brenda dy minutash të tërhiqet nga kjo pjesë. Dhe, nëse brenda dy minutave nuk tërhiqen, do të tërhiqen me forcë.

Unë kërkoj nga sigurimi i Parlamentit, që t'i nxjerrë jashtë Glaukun dhe Visar Ymerin.

(Ndërhyrje)

Jo! Kur të largohen këta mund të merret fjala.

Për hir të opinionit, po e lexoj nenin 41 të Rregullores së Kuvendit.

- Kryetari i Kuvendit kujdeset për rregull dhe mirëvajtje të mbledhjeve të Kuvendit.
- Kryetari ia tërheq vërejtjen secilit deputet ose anëtar të Qeverisë, kur diskutuesi shmanget nga çështjet e shtruara për diskutim, kur gjatë mbledhjes e kryen ndonjë veprim, që prish rregullin e punës së Kuvendit.

Në këtë rast është prishur rregulli i punës së Kuvendit.

Ftoj organet përgjegjëse të sigurisë, që deputetin Glauk Konjufca dhe Visar Ymeri t'i nxjerrin jashtë.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Në rastin, kur kërkohet veprimi plotësues duke përfshirë edhe ndërhyrjen e një ose më shumë zyrtarëve të policisë, kryetari i Kuvendit konsultohet me Kryesinë, para se të urdhërojë një masë të tillë disiplinore.

Ne jemi konsultuar me Kryesinë, dhe Grupi i “Vetëvendosjes” e ka të drejtën me 40 nënshkrime të thërrasë seancën e jashtëzakonshme, nuk i ka bërë.

Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” e ka të drejtën me Rregullore të Kuvendit të shtrojë kërkesën, mocionin për seancë urgjente e këtë nuk duan ta shfrytëzojnë.

Prandaj, kërkoj që sigurimi të kryejë punën e vet dhe të na mundësojë punën e seancës.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Kryesia, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, e përcakton rendin e ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Rendi i ditës u dërgohet deputetëve.

Rendi i ditës konsiderohet i miratuar, përveçse kur në fillim të mbledhjes, një ose më shumë grupe parlamentare, përfaqësuese të një ose më shumë komisioneve, së paku 6 deputetë ia propozojnë me shkrim kryetarit një amendament në rendin e ditës, përkatësisht nëse një deputet e ngrit një çështje të ngutshme dhe kjo merr miratimin e shumicës.

Shqyrtimi i çështjeve urgjente

Në secilën mbledhje plenare, deputeti duke e njoftuar paraprakisht kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi ta shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente, e cila duhet të jetë në përputhje me ... e shtojcës së parë të shprehjeve të Rregullores.

Kryetari i Kuvendit ia mundëson deputetit të propozojë në Kuvend dhe propozimi i tij vihet në votim. Nëse Kuvendi me votim vendos të marrë çështjen parasysht, çështja radhitet në rendin e ditës së mbledhjes.

Propozimi i grupeve parlamentare për shqyrtimin, shqyrtimin e çështjeve urgjente e vendos me votim në Kuvend.

Ne nuk kemi një kërkesë të tillë. Fjalën e ka deputeti, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zotni kryetar!

Ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkojmë që nga rendi i ditës të hiqet pika e 4-të, për arsye se marrëveshja, kushtimisht të them, ka qenë dhe ekziston procesverbali, që herën e kaluar është tërhequr pika dhe është thënë që në marrëveshje me Fondin Monetar, po që ka nënkuptuar sigurisht edhe me ne, të vihet kjo pikë e rendit të ditës.

Kjo nuk ka ndodhur, zotni kryetar, nuk kanë pushuar asnjë arsye të cilat kanë qenë, pse herën e kaluar nuk kemi marrë pjesë në seancë dhe ligji ka ardhur i njëjti siç ka qenë në leximin e dytë dhe ne kërkojmë, domethënë, si Grup Parlamentar, të hedhet në votim

propozimi ynë, që në këtë rast është mocion, që ky projektligj të hiqet nga rendi i ditës. Falemnderit!

KRYETARI: E ka fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Mendoj se s'ka mbetur vend për debat, po shpresoj që gjithkush provon ta kryejë pjesën e vetë të punës. E kemi njëfarë përgjegjësie edhe qysh duket totali i Kosovës jo vetëm qysh dukemi ne veç e veç, një nga një në Kuvend të Kosovës.

Unë shpresoj që njerëzit që janë në Kuvend, nisin ta shohin edhe qysh duket Kosova në total, jo vetëm veç e veç. Nuk kemi nevojë të na shndërrohet Kuvendi as në skenë të largimit, po as në teatër. Falemnderit!

Dikush tjetër prej shefave të grupeve, a e do fjalën? Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryetar!

Unë e kam përpara edhe transkriptin, po besoj se nuk kam nevojë kolegëve t'ua lexoj fjalë për fjalë atë që është kërkuar në seancën e kaluar. Nuk kam kërkuar ta heq dhe t'ia kthej Qeverisë, por decidivisht kam kërkuar që të hiqet nga rendi i ditës për seancën e kaluar dhe të futet në seancën e radhës, pas diskutimit me fondin Monetar Ndërkombëtar dhe të tjerët.

Ne, atë që kemi mund ta gjejmë si gjuhë të përbashkët me Fondin Monetar Ndërkombëtar është një pasus, që kemi arritur te kapitulli 2, institucionet mikrofinanciare e tjera, mos t'ju lodhi me citime, po kemi arritur vetëm një pasus të fusim dhe ai është si plotësim.

- Organizatat joqeveritare që kryejnë aktivitete të tjera jo financiare nuk janë subjekt i këtij ligji. Kjo është ajo që ne kemi mund të arrijmë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ne si Grup Parlamentar jemi të vendosur dhe kërkojmë nga deputetët, për hir të interesave të vendit, sepse janë në pyetje 160.000.000 euro investime e donacione, për të mos i humbur dhe kjo ka një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin ekonomik të vendit, që ne në Parlament debatojmë shpeshherë dhe për qytetarët e Kosovës, humbja 160.000.000 eurove investime do të thotë shumë.

Por njëkohësisht, në aspektin politik, ne e humbim nënshkrimin e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, prandaj unë u bëj thirrje të gjithë deputetëve, jo për hir të PDK-së dhe të koalicionit, por për hir të interesave të vendit të votojmë këtë ligj. Ju falemnderit!

KRYETARI: Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Është e domosdoshme që Kuvendi i Republikës së Kosovës të mbajë seancë të jashtëzakonshme, sot. Sulmet terroriste dhe kriminale të strukturave ilegale të Serbisë në veri të qytetit të Mitrovicës janë shtuar.

Të dielën u vra Selver Haradinaj si dhe u lënduan grua ja dhe fëmijët e tij, kurse një ditë më vonë u shkatërrua pika statike e Policisë së Kosovës. Qytetarët në Mitrovicë jetojnë në ankth, sepse janë të kërcënuar dhe janë të pambrojtur. Kjo pra, vetë frika, është edhe qëllimi i aksionit terrorist që ndodhi të dielën.

Nëse pajtohen të gjithë që ajo që ka ndodhur në Mitrovicë, është aksion terrorist, atëherë duhet ta kemi të qartë se si duhet të jetë sjellja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në lidhje me aktet terroriste. Ne, nëse nuk mbajmë seancë të jashtëzakonshme sot, pra moslejimi i seancës së jashtëzakonshme është indiferencë, paraqet indiferencë ndaj terrorizmit. Gjërat duhet të emërtohen me emrin që e kanë dhe duhet të trajtohen sipas rëndësisë që e kanë.

Madje, edhe pika e rëndomtë për problemet e veriut, në një seancë të rëndomtë, është përçmuese për gjendjen atje. Dhe, kjo është edhe më e rëndë pra, se mos mbajtja e seancës dhe gjithashtu është e papranueshme pra, të vazhdojë një seancë e rëndomtë në këtë gjendje.

Nëse të gjithë pajtohen që në veri ka ndodhur akti terrorist, sjellja e Kuvendit dhe institucioneve të Kosovës, duhet të jetë në përputhje me këtë veprim. Prandaj, ju lusim të gjithëve t'i jepni nënshkrimet, ta mbajmë seancën e jashtëzakonshme në përputhje me rrethanat. Të mos harrojmë, nëse nuk mbajmë seancë të jashtëzakonshme mbas një akti terrorist, ne po paraqitemi indiferent ndaj kësaj gjëje, ndaj këtij veprimi.

Duhet të jemi shumë të kujdesshëm, kjo është pikërisht imazhi i Kosovës, se si reagon ndaj terrorizmit kudo në botë, e po ashtu edhe në Kosovë.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Ne jemi duke ndërtuar shtet, jemi duke ndërtuar demokraci dhe ajo anarki dhe rrugaçëri në Kuvend. Ne e dimë çka ka ndodhur edhe në Mitrovicë dhe e dimë që situata nuk është e mirë as atje dhe ka probleme të shumta, jo vetëm në atë pjesë, por në gjithë Kosovën.

Institucionet, me Kushtetutë i kanë të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Me Kushtetutë, Kuvendi nuk ka të drejtë ta shpallë gjendjen e jashtëzakonshme. Kjo është nën një.

Nën dy, Kuvendi mund të organizojë seancë të jashtëzakonshme nëse e thërret presidentja e vendit, nëse e thërret kryeministri i vendit dhe nëse për këtë nënshkruajnë 40 deputetë, kështu shkruan në Kushtetutë, mbi bazën e së cilës të gjithë këtu edhe ju të "Vetëvendosjes" keni ardhur në këtë Kuvend.

Tjetër, përveç mundësisë së seancës së jashtëzakonshme, Rregullorja e punës e ka përcaktuar edhe mundësinë tjetër. Mocionin tuaj për seancë urgjente, nuk e keni shfrytëzuar këtë të drejtë. E keni pasur të drejtën dhe e keni të drejtën ta kërkonit fjalën

si deputetë dhe pastaj janë deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët e përcaktojnë, a do të mbahet seancë urgjente apo jo? Ne e kemi një Rregullore dhe këtë Rregullore duhet ta respektojmë edhe ne, këtë Rregullore duhet ta respektoni edhe ju.

Dhe, sigurisht, që jo vetëm ju e doni Kosovën dhe të tjerët, qenkan tradhtarë të saj.

Zonja dhe zotërinj, mosha jonë nuk ndryshon shumë. Dhe, kemi pasur mundësi, secili nga ne ta tregojmë vendosmërinë në kohën e caktuar dhe dikush e ka treguar e dikush s'e ka treguar atë. Por, te fundi i fundit, ajo është e kaluar dhe unë s'dua të merrem me të. Tani jemi këtu, e kemi Kushtetutën, e kemi Rregulloren e Kuvendit dhe Rregulloren duhet ta zbatojmë.

Ju po e thyni, ju po e shkelni edhe Kushtetutën, ju po doni ta impononi mendimin e grupit tuaj për vetvete, edhe pse në kërkesën e juaj për seancë të jashtëzakonshme edhe unë ua dhashë nënshkrimin. Po, i keni vetëm 12 nënshkrime, s'keni më shumë.

Ky është vullneti i deputetëve të Kuvendit të Kosovës edhe këta nuk janë që të mos... edhe u bisedua në takimin që patëm. Edhe Lidhja Demokratike nuk qe kundër bisedimit për, jo vetëm për atë pjesë, por për shumë probleme që i ka Kosova. Por, jo pa prezencën e kryeministrit dhe jo, pa prezencën e gjithë Kabinetit Qeveritar. Kështu është thënë nga të gjithë.

Prandaj, unë edhe njëherë po them, është mirë që ta lironi punën e Kuvendit, të shkojë sipas Rregullores së cilës kemi punuar. Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zotni kryetar, e thatë ju atë që ne e biseduam lart. Lidhja Demokratike e Kosovës është për të mbajtur seancë të jashtëzakonshme dhe ne ju propozuam që gjatë javës së ardhshme të ulemi grupet parlamentare, flas, opozitare dhe LDK-ja e ka gatishmërinë t'i jap nënshkrimet dhe të jetë nëse mund të thuhet, bashkorganizatore e një seance të tillë, kuptohet, proceduralisht.

Por, edhe sot po e përsërisim, ne nuk jemi për seancë të jashtëzakonshme pa qenë kryeministri i vendit këtu dhe pa e biseduar edhe pa dalë me qëndrime të qarta, çka dëshirojmë. Ne jemi, ne bashkëndojmë me atë çka po ndodh atje, nuk jemi indiferentë, por jemi që të respektohen edhe procedurat edhe të jetë kryeministri. Kushti i vetëm i LDK-së, është që të jetë kryeministri i Kosovës këtu, të debatojmë, t'i themi gjërat në Kuvend.

Kjo është ajo dhe nuk është LDK-ja kundër mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme.

Këtë e kemi thënë edhe dje në konferencë për shtyp edhe sot po e përsërisim. Kjo është ajo, qëndrimi i LDK-së.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Kryeministri mund edhe të mos vjen prej Shteteve të Bashkuara të Amerikë, pra mund të qëndrojë atje edhe një muaj, dy, nuk e dimë sa, ndërsa, ajo çka ka ndodhur nuk mund të anashkalohet. Nuk mund të presim të vjen kryeministri. Ne jemi Kuvend i pavarur dhe ne mund të marrim vendimet. Ne, këtu mund të marrim vendime dhe ta diskutojmë çështjen e terrorizmit. Pra, çështjen e terrorizmit thjeshtë, duhet të diskutojmë dhe të marrim vendime, të japim rekomandime konkrete, obligime për Qeverinë. Qe ku është Qeveria këtu, është këtu edhe ministri i brendshëm. Kaq.

KRYETARI: Unë e kërkoj një deklaram edhe një herë të kryetarëve të grupeve parlamentare.

Presion të gjithë njerëzit do të bëjnë, është obligim i secilit ta durojë ose mos ta durojë. Është punë e tyre, nuk është punë imja. Po, punë e tyre është, nuk është punë e jotja, ti duroje.

Unë e kërkoj një prononcim, a pajtoheni me fjalën e deputetit të Grupit “Vetëvendosje”, Liburn Aliut?

E ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Adem Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne të gjithë e dimë se situata në veri të vendit është shqetësim dhe preokupim jo vetëm për ne deputetët, por për çdo qytetar të Kosovës, pa marrë parasysh se ku është çfarë niveli të përgjegjësisë ka.

Ne jemi dëshmitarë se atje po terrorizohet një pjesë e territorit të Kosovës, një pjesë e qytetarëve të Kosovës, pavarësisht prej nacionalitetit se cilit i përkasin.

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike edhe në konsultë, që ishim bashkë, unë thashë se asnjëherë nuk i kemi ikur dhe nuk i ikim debateve, ngritjes së shqetësimeve dhe gjetjes së gjuhës së përbashkët dhe përcaktimit të mjeteve sa më të drejta, sa më adekuate, që na çojnë drejt zgjidhjes së problemit e kurrësi drejt rëndimit të jetës së qytetarëve atje dhe komplikimit të edhe mëtutjeshëm të situatës.

Ne kërkuam edhe atje, kërkoj edhe nga kolegët, shefat e grupeve parlamentare, paraprakisht duam të dimë se çka duam të arrijmë me një debat, që e hapim në Parlament? Jemi kundër shfryrjes së ndjenjave personale me sharje, fyerje të brendshme, sepse çështja e veriut nuk është që i takon vetëm institucioneve vendore, këtë të gjithë e dimë, por jo vetëm e Qeverisë së Kosovës, por janë edhe shumë aktorë të tjerë ndërkombëtarë, me të cilët vërtetë duhet të konsultohemi shumë seriozisht dhe t'i përcaktojmë mjetet më të drejta, më adekuate, për zgjidhjen e problemit dhe sigurimin e jetës së gjithë qytetarëve, pa përjashtim.

Prandaj, ne nuk pranojmë imponim nga asnjë grup, nga asnjë deputet, kushdo qoftë ai, që të na imponojë jashtë rregullave, jashtë procedurave, që janë të përcaktuara, por mbi bazën e të gjitha procedurave dhe marrëveshjeve të domosdoshme, jo të nevojshme, po të

domosdoshme që janë, që të gjenden për zgjidhjen e këtij problemi. Prandaj, ne nuk e përkrahim këtë formë, që kërkon Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”.

KRYETARI: Në emër të LDK-së, kryetari deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zotni kryetar, unë e thashë qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ne jemi për seancë të jashtëzakonshme, kur të është kryeministri i Kosovës në Kosovë edhe këtu para nesh, që ka edhe përgjegjësi. Kaq.

KRYETARI: Ardian, a e do fjalën? Fjalën e ka deputetit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit edhe njëherë, zoti kryetar!

Dje ishte një pajtim që të mbahet seancë e domosdoshme, e nevojshme, kur të kthehet kryeministri në Kosovë. Edhe sot u tha një gjë e tillë dhe ne mendojmë se ajo është rruga e mirë, nuk kemi nevojë t’iu flasim karrigeve, por sidoqoftë, po më duket se prapëseprapë është prishur atmosfera dhe nuk ka atmosferë. Ne propozojmë që të ndërkrehet seanca. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Edhe pse skenat brenda Kuvendit nuk na takojnë si deputetë, ne në mbledhjen e Kryesisë dhe në takimin e sotëm u kuptuam që jemi për mbajtje të një seance të jashtëzakonshme, mirëpo me prezencën e kryeministrit Hashim Thaçi dhe gjithë Kabinetit Qeveritar. Duke marrë parasysh se të gjithë jemi përfaqësues të qytetarëve të Kosovës brenda Kuvendit të Kosovës dhe gjithë qytetarët e Kosovës i kanë sytë nga ne, atëherë të tregojmë se jemi parlamentarë dhe dimë t’i zbatojmë rregulloret dhe dimë të debatojmë në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Edhe një herë kisha kërkuar, në rast se ka mundësi të bëhet mbas prezantimit të shfave të grupeve, një pauzë 10-minutash. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Grupi Parlamentar “6+” e ka dhënë qëndrimin e vet edhe dje në mbledhjen e Kryesisë dhe ne i qëndrojmë besnik këtij vendimi.

Ne jemi për ta vazhduar seancën e rregullt, ndërsa sa i përket seancës së jashtëzakonshme, mendoj se kur të piqen kushtet dhe kur të ndiqen procedurat e nevojshme, atëherë pse jo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, deputeti, kryetari i Grupit, Sasha Milosavljeviqi e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Parlamentarna Grupa Samostalne Liberalne Stranke ne može da prihvati nešto što krši pravilnik i zakon Kosova. Tako da mi nismo za to da se danas održi ovaj mocija i predlog Parlamentarne grupe „Vetevendosja“, a kada se budu ispoštovale sve procedure za vanrednu sednicu, mi ćemo rado prisustvovati u toj sednici i učestvovati na njoj. Hvala vam!

KRYETARI: Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha të bëj një propozim, që ndoshta do të ishte kompromis midis dy qëndrimeve.

Të “Vetëvendosjes” që sot të ketë një qëndrim lidhur me situatën në veri dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, që seanca e jashtëzakonshme të mbahet pasi të jetë këtu kryeministri.

Unë këtu dëgjova që kryeministri do të jetë nesër këtu, prandaj unë propozoj që sot Kuvendi të dalë me një deklaratë, të ndërprehet seanca për një kohë, të hartohet një deklaratë dhe të votohet si deklaratë, me të cilën dënohet sulmi atje, ndërkohë që seanca e jashtëzakonshme të thirret për nesër, të shpejtohen procedurat dhe të thirret për nesër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Mendoj që nuk kemi nevojë të vazhdojmë me fjalë. Konsideroj që edhe mosrespektimi i Kushtetutës nga ne, nën arsyetimin e terrorizimit të qytetarëve në veri të Mitrovicës është një lloj i terrorizmit politik, që po e shohim në Kuvend dhe realisht nuk është mirë, që kjo formë e terrorizmit politik, që vendos “Vetëvendosja” në Kuvend, shkon në favor të qarqeve që vërtet nuk ia duan të mirën këtij vendi dhe që krijojnë anarki dhe pasiguri në vend.

Unë edhe njëherë u kisha bërë thirrje nënkryetarit të Kuvendit, deputetit Glauk Konjuvca dhe Visar Ymerit, që ta lirojnë këtë hapësirë, që e kanë zënë pa të drejtë. Dhjetë minuta pauzë.

Unë kërkoj nga, vetëm nga anëtarët e Kryesisë, nënkryetarët e Kuvendit, një konsultë të shkurtër.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar Adem Grabovci, e ka fjalën!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Për hir të rrjedhës së punimeve, është diçka e pazakonshme që po ndodhë në Parlamentin e Kosovës, por ne si Grup Parlamentar i propozojmë Parlamentit që mos të përdoret dhuna dhe të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës, ashtu siç janë paraparë.

Pika e parë, veç u konsumua dhe kalojmë në Ligjin për bankat. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, faleminderit!

Unë të lus, se ishte një kërkesë, një mocion i Grupit tonë Parlamentar pikërisht për Ligjin për bankat dhe institucionet mikrofinanciare dhe unë kërkoj që të hidhet në votim. Kërkesa ishte që të tërhiqet ky ligj nga rendi i ditës. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Sa kemi prezentë? 98 janë prezentë! Mirë! Kërkoj nga regjia të përgatitet për votim! E votojmë propozimin...

(Ndërhyrje - reagim)

Ju lutem, ju lutem! E kanë bërë më herët Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike.

(Ndërhyrje)

Nuk kanë nevojë me u deklarua, me votim deklarohe mi.

Lus regjinë të përgatitet për votim dhe e votojmë tash propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të bërë nga deputeti Ismet Beqiri. Votojmë tash!

Me 30 vota për, 50 kundër, asnjë abstenim, nuk miratohet propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

Tash e qesim në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetit Adem Grabovci, për të kaluar menjëherë në miratimin e Procesverbalit të mbledhjes më 29 e 30 mars dhe 2, 5 e 6 prill 2012 dhe pikën e katërt - Ligjin për bankat dhe institucionet mikrofinanciare.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Me 53 vota për, 27 kundër, 3 abstenime, miratohet propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Vazhdojmë me pikën e 3-të të rendit të ditës:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29 e 30 mars dhe më 5 e 6 prill 2012.

A ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka

Atëherë, konstatoj se Kuvendi e miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtura më 29 e 30 mars dhe të vazhdimit më 5 e 6 prill 2012.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

(Deputetë të opozitës, lëshojnë sallën)

4. Projektligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka punuar shumë kujdesshëm në Projektligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe e ka bërë amendamentimin e Ligjit.

Ligji ka pësuar ndryshime nga ai varianti që na ka ardhur në fillim.

Ndërsa, në fillim të gjithë kemi pasur ngapak dyshim në lidhje me atë që është ardhur në ligj, mirëpo me amendamentimin, i cili i është bërë projektligjit dhe me plotësim-ndryshimet të cilat janë bërë në ligj, konstatoj se në emër të Komisionit se është një ligj shumë mirë i përgatitur dhe është punuar shumë me kujdes.

Kemi pas të angazhuar ekspertë vendorë por, kemi pas të angazhuar edhe ekspertë ndërkombëtarë, të cilët e njohin mirë këtë fushë.

Jemi konsultuar në vazhdimësi me Fondin Monetar Ndërkombëtar. I kemi marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet, të cilat na janë dhënë nga ana e EULEX-it dhe kemi koordinuar aktivitetin dhe punën tonë edhe me Komisionin Evropian.

Prandaj, në emër të Komisionit për Buxhet e Financa se Ligji është i përgatitur mirë, amendamentet janë të përgatitura mirë dhe kërkoj nga të gjithë deputetët, që t'i përkrahin këto amendamente.

KRYETARI: Falemnderit!

(Ndërhyrje)

Ju lutem, ju lutem! Asnjë fjalë nuk e dua!

Kemi 62 deputetë, vazhdojmë me...

(Ndërhyrje – reagim)

Mirë 64! U bë! Falemnderit shumë!

A ka kundër për amendamentin 1? Nuk ka!

Abstënim? Nuk ka!

Miratohet!

Amendamenti 2.

Këtu ka propozim. Urdhëro! Muhamet Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Ju lutem!

Meqenëse situata është mjaftë e rënduar, ne nuk duhet të bëjmë më tutje gabime dhe duhet me kujdes ta udhëheqim seancën dhe të bëjmë zgjidhje sa më racionale.

Unë plotësisht e mbështes fjalën e kryetares së Komisionit për Buxhet se është bërë një përpjekje e madhe, që të gjenden zgjidhje racionale dhe të pranueshme për një materie mjaft të ndërlikuar. Dhe, mendoj se ne kemi arritur që deri diku të bëjmë atë që është më optimale në këtë situatë.

Janë edhe dy-tri gjëra, të cilat mund të krijojnë probleme, mund të krijojnë shqetësime për arsye të konfliktit të këtij ligji me Ligjin mbi OJQ-të, në 2 – 3 nene dhe unë ju kisha lutur që edhe pse ato nuk janë përfshirë sa duhet në amendamente, të kemi durim dhe kujdes që t'i fusim edhe ato ndryshime, në mënyrë që mos të vazhdojë konflikti i mëtutjeshëm rreth këtij ligji, qoftë në Gjykatën Kushtetuese, qoftë tjetërkund.

Andaj konkretisht kur të vijmë atje te neni 90, po e kam pa atë, te definimet, duhet të përmendim edhe Ligjin mbi liritë e asociimit në organizatave joqeveritare;

Te neni 110 kur flasim për likuidimin e OJQ-ve mikrofinanciare, duhet të zbatohet edhe Ligji që është në fuqi për OJQ, se s'mund ta injorojmë ne një ligj që është në fuqi për OJQ-të dhe natyrisht, në bankat mund t'i investojnë vetëm ato institucione mikrofinanciare, që nuk janë OJQ.

Këto tri gjëra dhe këto tri nene, domethënë te neni 112, me këto tri përmirësime, mendoj se do ta kishim një zgjidhje shumë të mirë rreth këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për amendamentin 2, a ka kundër! Nuk ka!

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 5.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 6.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 7.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 8.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 9.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 10.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 11.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 12.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 13.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 14.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 15.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 16.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Prezentë janë 61 deputetë.

Amendamenti 17.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 18.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 19.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 20.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 21.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 22.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 23.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 24.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 25.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 26.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 27.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 28.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 29.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 30.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 31.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 32.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 33.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 34.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 35.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 36.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 37.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 38.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 39.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 40.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 41.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 42.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 43.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 44.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 45.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 46.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 47.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 48.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 49.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 50.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 51.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 52.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 53.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 54.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 55.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 56.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 57.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 58.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 59.

Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: Amendamenti 59, në frymën e asaj që thash, mendoj se tek likuidimi i OJQ-ve, përkatësisht edhe i OJQ-ve mikrofinanciare, meqenëse në këtë moment e kanë statusin e OJQ-ve, kur likuidohen te ato përpos dispozitave të këtij ligji, duhet të zbatohet edhe dispozitat e ligjit mbi OJQ-të, sepse vijnë në konflikt me dy ligje.

Prandaj, në fund të amendamentit, aty ku shkruan “BQK-ja”, para BQK-së “për qëllime bamirësie,” propozoj të jetë: “sipas Ligjit mbi lirinë e asociimit në OJQ dhe planit të miratuar nga BQK-ja.”.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja, Safete Hadërgjonaj! Kërkoj falje, më parë le ta merr fjalën Fatmir Xhelili, se më duket e kërkoi fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kabinetin!

Të nderuar deputetë,

Unë besoj që duhet me i dalluar te ky propozim organizatat joqeveritare, që merren me financa financiare edhe vetëm organizatat joqeveritare. Kështu që, falimentimi vlen vetëm për ato që nuk merren me çështje financiare dhe me anën financiare.

KRYETARI: Kryetarja e Komisionit, Safete Hadërgjonaj, e ka fjalën!

SAFETE HADËRGJONAJ: Në fakt, neni 110, kështu siç është propozuar nga Komisioni funksional, është i rregulluar në bazë të propozimit, të cilin e tha Muhamet Mustafa. Domethënë, nëse kapitali fillestar i donatorit nuk kthehet, kapitali i dhuruar dhe suficiti i kapitalit do të shpërndahen për qëllime bamirësie, sipas planit të miratuar nga BQK-ja. Domethënë, është e njëjta gjë, dhe kështu parashihet edhe në Ligjin për lirinë e asociimit të OJQ-ve.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Muhamet Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Mendoj se kryetarja e dha një sqarim të mirë. Mirëpo, ne nuk duhet të vijmë në ndonjë konflikt midis ligjesh sepse ai ligj është në fuqi dhe këto në këtë moment e kanë statusin e OJQ-ve dhe në qoftë se likuidohen, natyrisht që ato duhet të likuidohen sipas ligjit me të cilin janë regjistruar, se ato janë regjistruar me Ligjin mbi OJQ-në. Prandaj, duhet të likuidohen me atë ligj, por meqenëse merren me financa, edhe me planin që e aprovon BQK-ja. Kështu që, mendoj se në këtë mënyrë ne nuk kishim me ardhur në konflikt.

(Ndërhyrje – sugjerime, konsultim)

KRYETARI: A bën pra kështu? Atëherë, le të qitet presja “, dhe në pajtim me Ligjin për OJQ-të.”. A jeni dakord kështu të shkojë? Mirë!

A jeni dakord që të bëhet ky ndryshim?

(Ndërhyrje: Kryetar, a bën një sqarim?)

Urdhëro! Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj!

SAFETE HADËRGJONAJ: Atëherë, unë kisha propozuar që këtu të shtohet kjo: “Nëse kapitali fillestar i donatorit nuk kthehet, kapitali i dhuruar dhe suficiti i kapitalit do të shpërndahet për qëllime bamirësie, sipas ligjeve në fuqi dhe sipas planit të miratuar nga BQK-ja.”.

(Sugjerime – Ndërprerje shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Do të thotë kjo kërkesë, a mund të shkojë kështu, sipas ligjit në fuqi, siç e tha deputetja Safete Hadërgjonaj? Mirë.

I kemi 60 deputetë. 1 na mungon.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Prezentë janë 61.

Vazhdojmë të votojmë amendamentin 59, që e propozoi deputetja Safete Hadërgjonaj.

A jeni dakord?

Kundër? Nuk ka.

Faleminderit!

Miratohet amendamenti 59.

Amendamenti 60.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 61.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 62.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 63.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 64.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 65.
Për te amendamenti 65, fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Kryetar,
Unë propozoj që amendamenti 65, kështu si ka qenë i formuluar nga Komisioni funksional, të ndryshohet dhe të thuhet se “ky ligj hyn në fuqi me 12 prill 2012”.

KRYETARI: Faleminderit! Ka qenë me 30 mars, dhe atë ditë s’është miratuar. E sot, është me 12 prill dhe mund të hyjë në fuqi, pasi mund të parashikohet me ligj edhe kështu.

Do të thotë, jeni dakord me propozimin e deputetes Safete Hadërgjonaj?

Atëherë miratohet edhe amendamenti 65 dhe i kemi përfunduar.

Në fund, kemi miratimin në tërësi të Ligjit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, dhe votojmë tash.

54 janë për, asnjë kundër, 1 abstenim. Deputeti Sasha nuk ka kartelë – 55 vota për, 4 kundër.

Prezentë janë 61.

(Ndërhyrje)

Abstenim janë 4, kundër nuk ka. Pra janë 55 për, 61 prezentë, ligji miratohet.

Mirë u pafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për transkriptim e Kuvendit të Kosovës